



C.nr.878/16

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri, me zyrtaren ligjore Lendita Pajaziti në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj të cilin e përfaqëson me autorizim [REDACTED], ndërhyrësve [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj të cilin e përfaqëson [REDACTED] nga fshati [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj të cilët i përfaqëson me autorizim [REDACTED] kundër të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED] ish nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDACTED] nga Ferizaj, në çështjen juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë, në seancën e mbajtur me date 22.06.2018, mori këtë:

### AKTGJYKIM

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj si e bazuar.

**II. VËRTETOHET** se paditësi [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj është pronar i patundshmërive dhe atë NK [REDACTED] vendi i quajtur "bregu", me sipër. 3559m<sup>2</sup>, NK [REDACTED], vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 1707m<sup>2</sup>, NK [REDACTED] vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 5665m<sup>2</sup>, NK.nr [REDACTED], vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 4398m<sup>2</sup>, NK [REDACTED], vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 15095m<sup>2</sup>, NK [REDACTED] vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 1274m<sup>2</sup>, NK.nr [REDACTED], vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 6473m<sup>2</sup>, NK [REDACTED], vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 8345m<sup>2</sup>, NK [REDACTED] vendi i quajtur "Bregu", me sipër. 1325m<sup>2</sup>, NK [REDACTED], vendi i quajtur "Bregu", me sipër. 600m<sup>2</sup>, NK [REDACTED] vendi i quajtur "Bregu", me sipër. 1849m<sup>2</sup>, NK [REDACTED] vendi i quajtur "Bregu", me sipër. 6123m<sup>2</sup>, NK [REDACTED] vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 1650m<sup>2</sup>, NK [REDACTED], vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 4624m<sup>2</sup>, NK [REDACTED] vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 400m<sup>2</sup>, NK [REDACTED] vendi i quajtur "Utrinë", me sipër. 7997m<sup>2</sup>, NK [REDACTED] vendi i quajtur "Bregu", me sipër. 10796m<sup>2</sup>, ZK [REDACTED]

**III. DETYROHEN** të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED] ish nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj tani me adresë të panjohur, që t'ia njohin paditësit të drejtën e pronësisë në paluajtshmëritë e cekura në pikën II të dispozitivit, brenda afatit prej 15 ditësh, pas pranimit të

këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky aktgjykim pas plotfuqishmërisë do ti shërbej paditësit për bartjen e pronësisë në drejtorin për pronë gjeodezi dhe kadastër në Komunën e Ferizaj pa prezencën e tyre.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës

#### Ar sy e t i m i

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka deklaruar se mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë thënie e cekura në seancat e kaluara duke theksuar se nga administrimi i provave është vërtetua se paditësi këto prona i ka blerë nga i padituri në vitin 1972, në të cilën kohë është futur në posedim me mirëbesim dhe të ligjshëm, ku ndaj të paditurit e ka përmbushur detyrimin kontraktues sipas marrëveshjes, gojore e cila është vërtetuar edhe përmes dëgjimit të dëshmitarëve.

Njëherit ka shtuar se paditësi pasi që i ka blerë këto prona nga të paditurit gjysmën prej tyre ua ka shitur [REDAKTUAR] dhe tani të ndjerit [REDAKTUAR] të cilët ka raporte familjare, andaj ka theksuar se meqenëse me [REDAKTUAR] dhe me trashëgimtarët e të ndjerit [REDAKTUAR] dhe atë [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], nuk ka ndonjë kontest pronësor, e të cilët në këtë kontest janë paraqitur si ndërhyrës në anën e paditësit.

Sa i përket rrethanës se përse paditësi nuk e ka bërë bartjen e pronësisë në kohën e shitblerjes ka theksuar se ka pasur pengesa procedurale pasi që në atë kohë nuk ka qenë e mundur të bëhen bartjen e pronësisë nga qytetarët e nacionalitetit serb tek blerësit shqiptar, respektivisht të paditurit menjëherë janë shpërngulur në për në Serbi.

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që të aprovohet kërkesë padia e paditësit si e bazuar.

Ndërhyrësi [REDAKTUAR], të cilin e përfaqëson me autorizim [REDAKTUAR] ka deklaruar se e përka kërkesë padinë e paditësit në tërësi sa i përket pjesës së paluajtshmërisë të cilën e ka blerë nga paditësit e i cili paraprakisht e ka blerë nga të paditurit meqenëse me paditësin nuk kanë ndonjë kontest rreth pjesës së paluajtshmërisë së blerë andaj me të njëjtin ka theksuar se është pajtuar që fillimisht të bëhet barta e pronësisë në emër të paditësit e i cili pastaj me anë të kontratës interne t'ia bart pjesën e paluajtshmërisë ndërhyrësit [REDAKTUAR].

Andaj duke marr parasysh këtë ka kërkuar nga ana e gjykatës që të aprovohet kërkesë padia e paditësit në tërësi si e bazuar

Ndërhyrësit [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] të cilët janë trashëgimtar ligjor për të ndjerin [REDACTED] kanë deklaruar se e përkrahin në tërësi kërkesë padinë e paditësit sa i përket pjesës së paluajtshmërisë të cilën e ka blerë i ndjeri [REDACTED] nga paditësi e i cili paraprakisht e ka blerë nga të paditurit meqenëse trashëgimtarët e të ndjerit, ndërhyrësit nuk kanë ndonjë kontest pronësor rreth pjesës së paluajtshmërisë së blerë andaj me të njëjtin ka theksuar se është pajtuar që fillimisht e tërë paluajtshmëria të bartet në emër të paditësit e i cili pastaj me anë të kontratës interne t'ia bart pjesë e paluajtshmërisë ndërhyrësve secilit veç e veç në emër të tyre.

Andaj duke marr parasysh këtë ka kërkuar nga ana e gjykatës që të aprovohet kërkesë padia e paditësit në tërësi si e bazuar

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, thënieve të cekura në seancat e kaluara duke shtuar se nga administrimi i provave në këtë fazë të procedurës nuk e konteston të kërkesë padinë e paditësit pasi që nga dëgjimi i dëshmitarëve, ndërhyrësve daljes së gjykatës në vendin kontestues përputhen në tërësi pretendimet e paditësit me provat materiale pasi që paditësit në vitin 1972 e kishte blerë nga të paditurit pronën kontestuese e të cilën rreth gjysmën e saj ia kishte shitur ndërhyrësit [REDACTED] dhe të ndjerit [REDACTED].

Andaj ka deklaruar se deklarata e paditësi janë të besueshme dhe përputhet me gjendjen faktike duke deklaruar që gjykata të vendos në bazë të provave materiale njëherit i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata me qellim të vërtetimit në mënyrë të drejtë gjendjen faktike ka bërë administrimin e provave Lexohet padia e paditësit C.nr 878/16 dt.13.12.2016, autorizimi i paditësit dhënë të autorizuarit [REDACTED] i përpiluar dhe vërtetuar tek noteri [REDACTED] me nr. LRP.nr. 13102/2017 dt.23.10.2017, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 878/16 dt.25.10.2017 me të cilin të paditurve u është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDACTED] në tri gjuhë shqip, serbisht dhe anglisht, kërkesës e Gjykatë Themelore në Ferizaj C.nr.878/16

dt.25.10.2017, e cila i është dërguar Zyrës për Komunitete të Komunës së Ferizaj për sigurimin e eventual të adresës për të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED] njoftimi i Zyrës për Komunitete në Ferizaj me nr. 63/17 dt.30.10.2017, të cilët kanë deklaruar se nuk kanë informata se ku jetojnë tani të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED] përgjigja e të paditurve përmes përfaqësuesit të përkohshëm dt.11.12.2017, dëshmi vdekja për të ndjerin [REDACTED] dt.20.02.2018, certifikata e vdekjes për të ndjerin [REDACTED] m. Renf [REDACTED] nr. Ref [REDACTED] [REDACTED] dt.20.02.2018, autorizimi i ndërhyrësit [REDACTED] dhënë të autorizuarit [REDACTED] i vërtetuar tek noteri [REDACTED] me nr. LRP.nr. 1129/2018 dt.22.03.2018, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë [REDACTED] [REDACTED] dt.15.03.2018 të bashkangjitur edhe fl pos si dhe skica e matjes, autorizimi i ndërhyrëse [REDACTED] dhënë përfaqësueses [REDACTED] e vërtetuar tek noteri [REDACTED] me nr. LRP.nr.2539 /2018 dt.20.06.2018, autorizimi i ndërhyrëses [REDACTED] dhënë përfaqësueses [REDACTED] vërtetuar tek noteri [REDACTED] me nr. LRP.nr. 2554 /2018 dt.20.06.2018, procesverbali i dt.06.06.2018 me të cilën janë dëgjuar dëshmitarët [REDACTED] , [REDACTED] dhe [REDACTED].

Gjykata pasi beri shqyrtimin provave një nga një dhe të gjitha s'bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi me të paditurit ka lidhur marrëveshje gojore në vitin 1972 për shitblerjen e patundshmërive objekt kontesti, të cilën marrëveshje respektivisht detyrimin ndaj të paditurve e ka përmbushur në tërësi, kurse arsyeja e mos bartjes së saj ka qenë për faktin se të paditurit që në atë kohë janë shpërngulur në serbi me adresë të panjohur dhe nga ajo kohë nuk ka ndonjë informacion se ku jetojnë, por që nga ajo kohë paditësi është futur në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim të cilin posedim e ka pasur në mënyrë të pa ndërprerje dhe pa u penguar nga askush, dhe mbi bazën e shitblerjes e patundshmërive raportit civilo-juridik dhe parashkrimit fitues paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë.

Njëherit ka theksuar se pasi që i ka blerë këto prona nga të paditurit gjysmën e tyre ua ka shitur [REDACTED] dhe tani të ndjerit [REDACTED], nga e cila pjesë është zhveshur nga posedimi një pjesë të së cilës e ka në posedim [REDACTED] kurse pjesën tjetër e shfrytëzojnë respektivisht e kanë në posedim trashëgimtarët e [REDACTED] [REDACTED] bashkëshortja e tij dhe fëmijët [REDACTED] dhe [REDACTED], e cila vërtetohet me anë të dëshmi vdekjes së

dt.20.02.2018, e i cili fakt vërtetohet me anë të deklaratës së ndërhyrësve ku të njëjtit kanë theksuar se nuk kanë ndonjë kontest pronësor me paditësi për pjesën e pronës së blerë dhe me të njëjtin janë pajtuar që pasi që paditësi të bënë bartjen në emër të tij pastaj të na bart neve .

Gjykata me rastin e daljes në vendin kontestues s'bashku me ekspertin e gjeodezisë me dt.21.02.2018, sipas ekspertizës së dt.15.03.2018, përpiluar nga eksperti [REDAKTUAR] ka konstatuar se këto ngastrat kadastrale në vete përbëjnë një kompleks të gjerë të pronave që kufizohen njëra me tjetrën e të cilat i ka përshkruar hollësisht në ekspertizën e tij të përpiluar me shkrim.

Gjykata me dëgjimin e dëshmitarëve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ka vërtetuar faktin se paditësi nga të paditurit i ka blerë pronat kontestuese në vitin 1972, pasi që dëshmitari [REDAKTUAR] ka qenë prezent kur është arritur marrëveshja gojore në mes paditësit dhe të paditurve kurse me dëgjimin e dëshmitarit [REDAKTUAR] vërtetohet fakti se paditësi që nga koha e arritjes së marrëveshjes për shitblerjen e paluajtshmërisë këto prona i ka pasur në posedim të qet dhe të pa penguar nga askush, kurse me dëgjimin e dëshmitarit [REDAKTUAR] gjykata ka ardhur në përfundim se i njëjti edhe pse ka qenë në atë kohë i moshës së mitur i njëjti sipas thënieve të tij që ka kuptuar nga prindi i tij se ka qenë prezent me rastin e arritjes së marrëveshjes dhe se nga prindi i tij ka kuptuar se paditësit në atë kohë ia ka dhënë një pjesë të parave hua në emër të përmbushjes së detyrimit që ka pasur ndaj të paditurve e të cilat të holla në ndërkohë paditësi ia ka rikthyer prindit të tij, andaj gjykata duke marr parasysh provat materiale, deklaratat e dëshmitarëve të njëjtat përputhen në tërësi njëra me tjetrën dhe mbi këtë ua ka falur besimin dëshmisë së dëshmitarëve si objektive.

Andaj në rastin konkretë gjykata konsideron se pretendimet e paditësi se nuk ka mundur të bëjë bartjen e pronësisë në emër të tij edhe pse i kishte blerë nga të paditurit për shkak të shpërnguljen të paditurve nga fshati [REDAKTUAR] në Serbi menjëherë pas shitjes gjykata konsideron se këto pretendime janë të pjesërisht të qëndrueshme pasi që edhe pse paditësi ka mundur të lidhë kontratë të shitblerjes për të cilën nuk ka pasur ndonjë pengës-ndalesë një gjë të tillë nuk ka prova se e ka bërë, por përkundër kësaj gjykata sa i përket faktit të shitblerjes e ka vërtetuar me anë të dëgjimit të dëshmitarëve ku të njëjtit kanë deklaruar se paditësi që nga viti 1972 këto prona i ka në posedim të qetë dhe të pa penguar nga askush e të cilin posedim është futur tek pasi që e ka përmbushur detyrimin ndaj të paditurve nga e cila rrjedhë ligjshmëria e posedimi andaj

gjykata nuk ka gjetur ndonjë element me të cilin do ta vërtetonte të kundërtën e kësaj pasi që paditësi pasi që i ka blerë këto prona nga të paditurit gjysmën e saj ia ka shitur miqve të tij ndërhyrësve respektivisht trashëgimtarët e të cilit pastaj kanë ndërtuar shtëpitë e tyre e as këta nuk janë penguar nga askush aq më pak para vitit 1999.

Gjykata ka ardhur në përfundim se paditësi sipas bazës juridike të marrëveshjes mbi shitblerjen dhe mbajtjes me mirëbesim në kuptim të nenit 28 par.1,2 lidhur me par.4 të LTHMPJ e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërit e përshkruara si në pikën II të dispozitivit të cilat ngastra janë të përkufizuara njëra me tjetrën dhe si të tilla përbëjnë një kompleks në vete dhe me ngastra të tjera dhe me konstatimin e gjendjes faktike më hollësisht në procesverbalin e daljes në vendin kontestues me dt.21.06.2018, dhe me ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë Enver Pajaziti e dt.15.03.2018, e cila është pjesë e shkresave të lëndës.

Gjykata me rastin e vendosjes ka marr parasysh edhe vërejtjet e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurve, të paraqitura në përgjigje në padi, dhe thëniet e tij në seancat gjyqësore por të njëjtat për gjykatën kanë qenë vetëm procedurale, andaj dhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në nenin 450 të LPK-së secila palë ti bart shpenzimet e saj të procedurës pasi që paditësi ia ka përmbushur në tërësi obligimin e tij ndaj përfaqësuesit të përkohshëm.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**  
**C.nr.878/16, me datën 22.06.2018**


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVOS

VENDIM ËSHTË I PLOTËNDOR  
ODLUKA JE PRAVNO SILE  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNOG  
FERIZAJ II URBENAC

Më  
Dana

15.08.2018

Gjyqtari,  
Alban Beqiri



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatën së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.